



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

Datë 07.09.2021

FTESE PËR OFERTË

Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Bashkia Tiranë
Adresa	Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë
Tel/Fax	0035542256799
E-mail	administrative.prokurime@tirana.al
Adresa e Internetit	www.tirana.al

Autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë do të zhvillojë procedurën e prokurimit për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me objekt: **“Blerje 3 (tre) bileta udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë –Milano –Tiranë” si më poshtë:**

1. Blerje 1 (një) biletë udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë- Milano - Tiranë, si më poshtë:

- Itinerari: Tiranë –Milano -Tiranë
- Nisja nga Tirana drejt Milanos do të bëhet në datën 09.09.2021 herët në mëngjes dhe mbërritja në Milano para orës 08.30.
- Kthimi nga Milano drejt Tiranës do të bëhet në datën 12.09.2021 në darkë. Nisja nga Milano pasdite pas orës 17.30 dhe mbërritja në Tiranë në darkë para orës 20.00.
- Pa ndalesë
- Bagazhe të përfshira

2. Blerje 2 (dy) bileta udhëtimi vajtje-ardhje Tiranë- Milano - Tiranë, si më poshtë:

- Itinerari: Tiranë –Milano -Tiranë
- Nisja nga Tirana drejt Milanos do të bëhet në datën 08.09.2021 në mëngjes dhe mbërritja në Milano para orës 12.30.
- Kthimi nga Milano drejt Tiranës do të bëhet në datën 10.09.2021 në darkë. Nisja nga Milano pasdite dhe mbërritja në Tiranë në darkë para orës 22.00.
- Pa ndalesë

- Bagazhe të përfshira

Data e zhvillimit do të jetë **07.09.2021 ora 19.30** në adresën www.app.gov.al

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj për këtë objekt prokurimi me këto të dhëna (kërkesat specifike të objektit të prokurimit), si më poshtë:

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, ***Rezervimin e biletës sipas destinacionit të kërkuar.***

Operatori ekonomik i renditur i pari duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për realizimin /mosrealizimin e objektit të prokurimit, brenda 2 orëve nga momenti i njoftimit në sistem, në të kundërt operatori do të s'kualifikohet duke përzgjedhur ofertuesin ekonomik i renditur i dyti në listën e ofertave që kanë mbetur, deri në ofertuesin e renditur në vend të fundit.

**Operatori ekonomik së bashku me itinerarin e ofruar, duhet të paraqesë edhe të dhënat e kontaktit (numër telefoni, e-mail) në sistem. Nëse itinerari i ofruar nga OE është në përputhje me kërkesat e AK dhe sipas destinacionit të kërkuar, Autoriteti Kontraktor pas konfirmimit do të nis të dhënat e personave udhëtues në adresën elektronike (email) të Operatorit ekonomik.*

Afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës do të jetë menjëherë elektronikisht (email) brenda 2 orëve duke filluar nga momenti i shpalljes së fituesit.

Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në fushën e veprimtarisë së tij në QKR, objektin e prokurimit.

Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit në sistem.